



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INTEGRIMIT EUROPIAN

RAPORT Nr. 2/2017
PËR ECURINË E PROCESIT TË INTEGRIMIT

drejtuar

KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN,
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

për periudhën

PRILL–QERSHOR 2017

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
ECURIA E ZBATIMIT TË MSA-SË	4
VEPRIMTARIA E ORGANEVE MONITORUESE TË PROCESIT TË INTEGRIMIT	4
TAKIMET PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË MSA	5
ZBATIMI I NENIT 70 TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT: PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME ACQUIS E BASHKIMIT EUROPIAN	6
PARAPËRGATITJE PËR PROCESIN E NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN ..	6
MONITORIMI I PROGRESIT TË ARRITUR NË PESË PRIORITETET KYÇE GJATË PERIUDHËS PRILL-QERSHOR 2017	8
PËRAFRIMI DHE PËRKTHIMI I LEGJISLACIONIT	8
PLANI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EVROPIAN	11
FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE	12
BASHKËPUNIMI TERRITORIAL	12
IPA KOMBËTARE	15

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi European
DBE	Delegacioni i Bashkimit European
MED	Programi Transnacional Mesdheu
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integrimit European
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para- anëtarësimit
KE	Komisioni European
KKIPA	Koordinatori Kombëtar i IPA-s
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin European
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit)
WBIF	Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor

Hyrje

Bazuar në Ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, neni 19, pika 1, Ministria e Integrimit Evropian (MIE) paraqet çdo 3 muaj, pranë Komisionit Parlamentar të Integrimit, një raport të hollësishëm mbi listën e përditësuar të projektligjeve të lidhura me çështjet e integrimit evropian, të cilat do t’i kalojnë për shqyrtim Kuvendit për periudhën vijuese; ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim; raportimet e paraqitura pranë strukturave të Komisionit Evropian apo strukturave të përbashkëta, qëndrimet mbi çështjet e diskutuara, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga këto takime, zhvillimet dhe ecurinë e procesit të integrimit. Raporti periodik nr. 2/2017 përfshin zhvillimet dhe ecurinë e procesit të anëtarësimit për periudhën prill – qershor 2017.

Raporti është strukturuar sipas çështjeve kryesore të lidhura me procesin e integrimit, dhe përfshin ecurinë e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 28.05.2014 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për 5 Prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian 2013”, zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 25.1.2017, zhvillimin e takimeve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian, si dhe menaxhimin e programeve financiare të ndihmës së huaj, përfshirë dhe rritjen e kapaciteteve të administratës lidhur me procesin e integrimit.

Ky raport sjell gjithashtu, në mënyrë të detajuar, informacion mbi përkthimin, rishikimin dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, shkallën e përputhshmërisë së projekt-akteve që paraqiten për mendim pranë MIE-s gjatë periudhës kohore të raportimit, direktivat apo rregulloret e BE-së të përkthyer dhe të rishikuara.

Ecuria e zbatimit të MSA-së

Veprimtaria e organeve monitoruese të procesit të integrimit

Grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull negociues të ngritura mbi bazën e Urdhrit të Kryeministrit Nr. 107, datë 28.02.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”, u mbledhën rregullisht gjatë këtij tremujori. Takimet e zhvilluara gjatë periudhës prill-qershor 2017, u përqendruan në:

- analizën e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2017;
- ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga pala evropiane gjatë takimeve të përbashkëta Shqipëri-BE, si dhe në Raportin për Shqipërinë 2016;
- shpjegimin e procesit të screening per kapitujt 23 dhe 24, riformatimin e Grupeve ndërinstitucionale të punës për të reflektuar më mirë Acquis të cdo kapitulli, plotësimin e tabelave për evidentimin e mangësive ligjore dhe institucionale.
- dhënia e asistencës në kuadër të plotësimin të aplikimeve të TAIEX;etj

Takimet për monitorimin e zbatimit të MSA

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, u zhvilluan këto takime:

Më 28 prill 2017, u zhvillua në Bruksel, takimi i nëntë i Nënkomitetit “Drejtësi, Liri dhe Siguri”, midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë. Ky takim shërbeu për të kryer një vlerësim të përgjithshëm të progresit të arritur nga Shqipëria gjatë vitit të kaluar, veçanërisht për sa i përket zbatimit të reformës në drejtësi, luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar, përfshirë trafikimin e drogës, bashkëpunimin policor, azilin dhe migracionin, menaxhimin kufitar dhe politikatat e vizave, anti-terrorizmin, dhe të drejtat e njeriut. Gjate takimit të Nënkomitetit përfaqësuesit e institucioneve shqiptare prezantuan përditësimet dhe zhvillimet të cilat kanë vijuar pas publikimit të Raportit për Shqipërinë, 2016. Komisioni përgëzoi punën e bërë me kuadrin ligjor për të adresuar një sërë mangësish, duke përfshirë miratimin e kodit të drejtësisë për të miturit, miratimin e planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020, si dhe theksoi rëndësinë e krijimit të kushteve për zbatimin efektiv të tij. Rëndësi e veçantë iu kushtua zbatimit të reformës në drejtësi, përfshirë kryerjes së procesit të veting-ut, si kushte thelbësore për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Në qendër të vëmendjes gjithashtu do të mbahen të gjitha fushat të cilat mbulojnë 5 prioritetet kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim, si dhe vazhdimi i progresit të arritur në ngritjen e një historiku solid të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në zbatim të rekomandimeve të Komisionit Evropian, institucionet pjesëmarrëse në këtë Nënkomitet kanë filluar mbledhjen dhe përpunimin e informacionit të kërkuar nga shërbimet e Komisionit. Më shumë informacion mund të gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Integrimit Evropian: <http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/lajme/zhvillohet-takimi-i-nente-i-nenkomitetit-per-drejtësi-lirine-dhe-sigurine-be-shqiperi&page=1>

Në vijim të takimit të Nënkomitetit Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Zhvillimi Rajonal, Ministria e Integrimit është duke hartuar minutat e këtij takimi. Gjithashtu, është koordinuar puna për hartimin e një informacioni shtesë të kërkuar nga shërbimet e Komisionit Evropian. Më shumë informacion gjeni në: <http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/lajme/zhvillohet-takimi-i-tete-i-nenkomitetit-shqiperi-be-per-transportin-energji-mjedisin-dhe-zhvillimin-rajonal&page=2>

Në kuadër të adresimit të rekomandimeve të Nënkomitetit të Stabilizim Asociimit për Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet, të zhvilluar në 30 Mars 2017, u përgatit dhe u dërgua një informacion shtesë, i kërkuar nga shërbimet e Komisionit Evropian.

Gjatë tre-mujorit të dytë të vitit 2017, u finalizuan minutat e takimit të Nënkomitetit për Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, 2016, si dhe u hartua një informacion shtesë në kuadër të këtij takimi.

Zbatimi i nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit: Përafrimi i legjislacionit shqiptar me Acquis e Bashkimit Evropian

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017 u miratuan një numër aktesh të rëndësishme, të parashikuara në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2017-2020, për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian, si vijon:

- Ligji nr. 26/2017 "Mbi Produktet Kozmetike" datë 16.03.2017 i cili është përafuar pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 1223/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 30 nëntor 2009, "Për produktet kozmetike", të ndryshuar. CELEX 32009R1223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L. nr. 342, datë 22.12.2009.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 329, datë 12.4.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", i përafuar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit Nr 58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 "Për përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimine programeve Komunitare";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 372, datë 26.04.2017 "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të drejtat e fëmijëve" përafuar pjesërisht me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2010/C 83/02);
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 436, datë 17.5.2017, "Për procedurën e pajtimit dhe masën e shpërblimit të Zyrave Shtetërore të Pajtimit" i përafuar pjesërisht me Direktivën 2001/23/CE të datës 12 mars 2001 mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në rast të transferimit të ndërmarrjeve, ose pjesëve të ndërmarrjes".

Në kuadër të plotësimit të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2017 – 2020 janë miratuar edhe këto dokumente strategjike:

- Dokumenti Nr. 2564, datë 29.03.2017 Plani i veprimit për privatizimin/likuidimin e shoqërive tregtare në sektorët jostrategjikë;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 248, datë 29.3.2017 "Për miratimin e Planit të Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017–2020;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 439 datë 17.5.2017 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të shëndetësisë 2016-2020".

Parapërgatitje për procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian

Në kuadër të parapërgatitjes për procesin e negociatave, gjatë dy takimeve të mbajtura me datë 17 dhe 18 janar 2017 në Ministrinë e Integritimit Evropian, përfaqësuesit e Komisionit Evropian, Znj. Michela Matuella, Përgjegjëse e Njesisë për Shqipërinë në Komisionin Evropian dhe Z. Giulio Venneri, koordinator politik në Njesisë për Shqipërinë në Komisionin Evropian informuan se Këshilli Evropian vlerëson përparimin e bërë nga Shqipëria në të gjitha fushat në këto tre vitet e fundit. Si rezultat i këtyre arritjeve, Komisioni Evropian është angazhuar për përfshirjen e Shqipërisë në disa procese teknike të cilat normalisht kryhen vetëm pas hapjes zyrtare të negociatave të anëtarësimit.

Në vijim të këtyre takimeve, institucionet e përfshira në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për kapitujt 23 dhe 24 kanë përzgjedhur ekspertët përkatës në nivel teknik për të marrë pjesë në këtë proces.

Si pjesë e këtij procesi teknik, Komisioni Evropian zhvilloi dy takime shpjeguese (*pre-screening*) për Grupet Ndërinstitucionale të Punës, me qëllim njohjen e legjislacionit të Bashkimit Evropian të kapitujve negociues 23 – Drejtësia dhe të Drejtat themelore, dhe 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria. Takimi për Kapitullin 23 u zhvillua me datë 25 – 26 prill 2017, ndërsa takimi për Kapitullin 24 u zhvillua me datë 3 – 5 maj 2017. Të dy takimet u mbajtën në Bruksel. Në përgatitje të këtyre takimeve, Grupet Ndërinstitucionale të Punës për kapitujt 23 dhe 24 u riformatuan, duke sjellë në përbërje të tyre ekspertët e fushave të këtyre kapitujve sipas legjislacionit evropian. Gjatë takimit, ekspertë të ndryshëm të Drejtorive përkatëse në Komisionin Evropian, shpjeguan legjislacionin e BE-së, duke bërë një përmbledhje të këtij legjislacioni dhe duke u ndalur në nene të veçantë. Në përfundim të çdo prezantimi, ekspertët shqiptarë bënë pyetje të detajuara për çdo paqartësi në legjislacionin e BE-së, për të thelluar njohjen me këtë legjislacion. Për informacion më të detajuar Ministria e Integritimit Evropian ka dërguar pranë Kuvendit të Shqipërisë shkresat me nr. 1427 Prot. dhe nr. 1428 Prot. të datës 29.06.2017 “Mbi zhvillimin e procesit shqyrtues paraprak për kapitujt 23 dhe 24”.

Në përfundim të këtij takimi u kërkua nga të gjithë ekspertët që të kontribuojnë në një Plan të përbashkët Veprimi afat-shkurtër, në të cilin do të planifikohen hapa konkrete, me qëllim përafrimin e legjislacionit si dhe përmirësimin e zbatimit të legjislacionit të përafruar. Në mbështetje të hapave të mëtejshëm për të shfrytëzuar këto takime shpjeguese dhe për të kaluar në veprime konkrete nga institucionet, janë zhvilluar dy trajnime të mbështetur nga Projekti SMEI IV, në të cilat negociatori kapitujve 23 dhe 24 të Malit të Zi drejtoi ekspertët vendas, duke ndarë eksperiencën e Malit të Zi, lidhur me këtë fazë. Trajnimi i parë u zhvillua në datën 22 – 23 maj 2017, me pjesëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për kapitullin 23, kurse trajnimi i dytë me anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për kapitullin 24 në datat 12 – 13 qershor 2017, në Tiranë. Trajnimet kishin për qëllim ndarjen e eksperiencës së Malit të Zi, për plotësimin e tabelave me anë të të cilave do të bëhet identifikimi i mangësive ligjore dhe institucionale në procesin e pre-screening. Anëtarët e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës filluan si pjesë e trajnimit, krahasimin e legjislacionit shqiptar me Acquis të BE-së, me qëllim identifikimin e nevojave për hartimin e një Plani Veprimi për adresimin e mangësive ligjore dhe institucionale, duke pasur parasysh informacionin e dhënë gjatë takimeve shpjeguese të sipërpërmendura për kapitullin 23 dhe 24.

Procesi i hartimit të Planit të Veprimit për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit do të zhvillohet në dy faza. Në fazën e parë, Grupet Ndërinstitucional të Punës të kapitujve 23 dhe 24 do të angazhohen në analizën e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian për kapitujt 23 dhe 24 dhe vlerësimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e legjislacionit. Kjo analizë do të shërbejë për identifikimin e mangësive ligjore dhe institucionale në këta kapituj. Analiza e përgatitur nga Grupi Ndërinstitucional i Punës do të konsultohet me shërbimet e Komisionit Evropian dhe ekspertë ndërkombëtarë.

Në fazën e dytë, Grupet Ndërinstitucional të Punës të kapitujve 23 dhe 24 do të fokusohen në hartimin e Planit të Veprimit për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, në të cilin do të parashikohen masat e duhura për plotësimin e mangësive ligjore dhe institucionale të identifikuara.

Në datën 21 qershor 2017, u zhvillua pranë Ministrisë së Integritimit Evropian një mbledhje me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, koordinatorë të kapitujve përkatës, me qëllim ndarjen e eksperiencës së fituar deri më tani për kapitujt 23 dhe 24 në kuadër të procesit *pre screening*, si dhe shtrirjen e kësaj eksperience edhe në punën e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës që koordinojnë kapitujt e tjerë. Ky proces do të fillojë me përditësimin e pjesëtarëve të GNP-ve, sipas masave të *acquis* për çdo kapitull, duke vijuar me identifikimin e mangësive ligjore dhe institucionale sipas një metodologjie të caktuar. Procesi është planifikuar të realizohet brenda vitit 2017.

Monitorimi i progresit të arritur në pesë prioritetet kyçe gjatë periudhës prill-qershor 2017

Ministria e Integritimit Evropian filloi hartimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 330, datë 28.5.2014, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013” me qëllim miratimin e një “Plani Masash për rekomandimet afatshkurtra për vitin 2017””, një dokument pune i hartuar mbi bazën e rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016, dhe vijim i punës së nisur nga Udhërrëfyesi për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian. Projektvendimi ju paraqitet për mendim të gjitha ministrive dhe institucioneve të pavarura. Plani u miratua nga Bordi i Integritimit.

Ministria e Integritimit Evropian ka vijuar me monitorimin e zbatimit të masave të parashikuara në “Planin e Masave për rekomandimet afatshkurtra për vitin 2017”. Monitorimi kryhet në takimet periodike të Sekretariatit Teknik të Bordit të Integritimit. Nga monitorimi i deritanishëm i masave të këtij Plani, përqindja e miratimit të masave është 31.7%

Ministria e Integritimit Evropian ka vazhduar punën me institucionet përgjegjëse për 5 Prioritetet për përditësimin e progresit të bërë në zbatimin e masave të parashikuara në Udhërrëfyes, i cili dërgohet periodikisht pranë Komisionit Evropian.

Përafrimi dhe përkthimi i legjislacionit

Zbatimi i Nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit: Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian

Në plotësim të detyrimeve të Nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për përafrimin e *acquis* së BE-së dhe neneve në fusha të tjera të MSA-së, theksojmë fushat në të cilat ka patur përafrim thelbësorë plotë dhe të pjesshëm, si vijon:

Në plotësim të detyrimeve të parashikuara në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit për përafrimin e *acquis* së BE-së dhe të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2017 – 2020, fushat në të cilat ka pasur **përafrim të plotë** janë:

Në fushën e ekonomisë, Neni 70 “Përafrimi i legjislacionit”, është përafruar plotësisht:

- Projektvendimi “Për etiketimin e energjisë për furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës”, në zbatim të Vendimit nr. 584, datë 28.08.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar. Projektvendim është plotësisht i përputhshëm me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (EU) No 65/2014 e 1 tetor 2012, që plotëson Direktivën 2010/30/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit “në lidhje me etiketimin e energjisë për furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës”.

Në plotësim të detyrimeve të parashikuara në Nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për përafrimin e *acquis* së BE-së dhe të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017-2020, fushat në të cilat ka patur **përafrim të pjesshëm** janë:

Në fushën e ekonomisë, Neni 70 “Përafrimi i legjislacionit”, është përafruar pjesërisht:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9902 , datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, të ndryshuar”, vërejmë se ky projektligj është:
- plotësisht i përputhshëm me Direktivën 2011/83/BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e 25 tetorit 2011 “Mbi të drejtat e konsumatorit”, që ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13/KEE dhe Direktivën 1999/44/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 85/577/KEE dhe direktivën 97/7/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit; si dhe,
- pjesërisht i përputhshëm me Direktivën 2013/11/BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e 21 majit 2013 “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve dhe për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren (KE) Nr. 2006/2004 dhe në Direktivën 2009/22/KE (Direktiva për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve- ADR)”
- Projektvendimi “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”, në zbatim të Vendimit nr. 584, datë 28.08.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar. Projektvendimi është pjesërisht i përputhshëm me Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 651/2014, datë 17 Qershor 2014 “Për deklarimin e disa kategorive të ndihmës shtetërore të pajtueshme me tregun e përbashkët, në zbatim të nenit 107 dhe 108 të Traktatit”.

Në fushën e bujqësisë, Neni 70 “Përafrimi i legjislacionit” dhe neni 95 “Bujqësia dhe Sektori Agroindustrial” të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është përafruar pjesërisht:

- Projektvendimi “Për përshtatjen e sistemit të monitorimit satelitor të anijeve të peshkimit për regjistrimin elektronik dhe transmetimin e të dhënave të librit të anijes së peshkimit”, vërejmë se projektvendimi është pjesërisht i përputhshëm me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 1224/2009 e 20 Nëntorit 2009, Për ngritjen e një sistemi Komunitar të kontrollit me qëllim garantimin e përputhshmërisë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit (PPP).

Në fushën e financave, Neni 70 “Përafrimi i legjislacionit” dhe Neni 97 “Doganat” të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është përafruar pjesërisht:

- Projektvendimi “Për miratimin e rregullave të detajuara të disa dispozitave të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe projektvendimi, “Për miratimin e dispozitave zbatuese të disa dispozitave të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, projektvendimi, “Për miratimin e rregullave të detajuara të disa dispozitave të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” është pjesërisht i përputhshëm me Rregulloren e Komisionit Nr. 2015/2446 e 28 Korrikut 2015, për sa i përket rregullave të detajuara në lidhje me dispozitave të caktuara të Kodit Doganor të Bashkimit Europian dhe projektvendimi, “Për miratimin e dispozitave zbatuese të disa dispozitave të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” është pjesërisht i përputhshëm me Rregulloren Zbatuese nr. 2015/2447 e Komisionit e datës 24 Nëntor 2015 që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e disa dispozitave të Rregullores (BE) Nr 952/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që ka miratuar Kodin Doganor të Bashkimit.
- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar është pjesërisht i përputhshëm me Direktivën 2006/112/CE e Këshillit, datë 28 nëntor 2006, “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”.

Në fushën e mjedisit, Neni 108 “Mjedisi” i MSA-së janë kthyer për plotësim:

- Projektvendimi “Për rregullat për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe e produkteve e të pajisjeve, që përmbajnë këto substanca”.

Në fushën e energjisë, Neni 107 “Energjia” i MSA-së:

- Projektvendimi “Për miratimin e rregullores për kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për licensimin e audituesit të energjisë”.

Në fushën e shoqërisë së informacionit (Neni 103) aktet pa përafrim janë:

- Projektligji “Për qeverisjen elektronike”, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave” i ndryshuar, nuk synon përafrim të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian.
- Projektvendimi “Për përcaktimin e autoritetit përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe rezultateve në punë”, nuk synon përafrim të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian.
- Projektvendimi “Për standardizimin e rregullave, mënyrave, procedurave, njësive përgjegjëse për paraqitjen dhe për shqyrtimin e ankimeve ndaj ofrimit të shërbimeve publike”, nuk synon përafrim të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian.

Sektori i Rishikimit të Përkthimit të Legjislacionit

Në tremujorin e dytë, Sektori i Rishikimit të Përkthimit të Legjislacionit ka përpiluar kalendarin e akteve për përkthim dhe kanë përcaktuar të gjitha kriteret specifike për të nisur procedurat për tenderimin e kompanisë së përkthimit.

Gjithashtu, janë mbajtur disa takime me Komisionin Teknik mes Shqipërisë dhe Kosovës ku është punuar për Manualin e Përbashkët të Përkthimit.

Sektori i Përkthimit të Dokumenteve Strategjike të Integritit Evropian, për tremujorin e dytë të 2017, ka përkthyer:

- Kontratën e Reformës së Sektorit për Luftën Kundër Korrupsionit– Marrëveshja Financiare IPA 2016, e ndryshuar
- Kontratën e Reformës së Sektorit për Mbështetjen e Transportit, me Fokus tek Rrugët- Marrëveshja Financiare IPA 2016, e ndryshuar
- Kushtet e Veçanta dhe 2 Shtojca të Marrëveshjes së Financimit, Programi “*Interreg V-B Adriatic-Ionian*”
- Planin e Masave Afat-shkurtra për 5 prioritet, 2017
- Projekt-urdrin mbi përcaktimin e përgjegjësisë së nëpunësve civilë të MIE për Projektin “*Ngritja e kapaciteteve për Ministrinë e Integritit Evropian (MIE) dhe ministritë e linjës për përgatitjen e procesit të negociatave dhe përafrimit ligjor*”
- Vendimin për përcaktimin e zyrtarit të parregullsisë, Programi IPA CBC Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020
- Rastin gjyqësor studimor në kuadër të misionit të vlerësimit të anti-korrupsionit dhe krimin të organizuar nga Komisioni Evropian.

Plani Kombëtar i Integritit Evropian

Gjatë tremujorit të dytë është kryer monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar për Integritin Evropian 2017 – 2020, i cili u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 25.1.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integritin Evropian 2017 – 2020”. Ministria e Integritit ka realizuar analizën e shkallës së miratimit të planit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017, si vijon:

- Nga 56 projekt-akte të planifikuara për gjashtë-mujorin e parë të vitit 2017, vetëm 20 akte janë miratuar gjatë kësaj periudhe. **Përqindja e realizimit për këtë periudhë është 39.3%;**
- Nga 17 dokumente strategjike apo dokumente politikash, të planifikuara për tre-mujorin e parë të vitit 2017, 5 dokumenta janë miratuar gjatë kësaj periudhe. **Përqindja e realizimit për këtë periudhë është 29 %.**
- **Realizimi total i PKIE për këtë periudhë është 37%.**

Forcimi i kapaciteteve institucionale

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017, janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme për forcimin e kapaciteteve institucionale:

1. Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit IPA “*Mbështetje për reformën e shërbimit civil në Shqipëri*”, organizuan trajnimin katër ditor me temë: *Aftësimi për Negociatat me Bashkimin Evropian, në datat 10-14 Prill*, pranë ASPA.
2. Vizita studimore zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit “*Mbështetje për Reformën në Administratën Publike*” në Zagreb, Kroaci, në datat 5 – 9 qershor 2017;
3. Trajnimi “*Përgatitja për shqyrtim, ngritja e kapaciteteve për anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për kapitullin 23*, me datë 22 – 23 maj 2017, në Tiranë;
4. Trajnimi “*Përgatitja për shqyrtim, ngritja e kapaciteteve për anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për kapitullin 24* me datë 12 – 13 qershor 2017, në Tiranë;
5. Manaxhimi i asistencës financiare të BE - trajnim 14-ditor për njësitë IPA në Administratën qendrore, në datat 2-19 maj 2017;
6. Trajnimi me temë “*Video-survejsimi dhe mbrojtja e të dhënave personale*”, me datë 15 qershor 2017, në Tiranë, nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri;
7. Seminari rajonal nga instrumenti TAIEX me datën 10,11,dhe 12 maj 2017 në Bruksel mbi Hartimin e Programit të Reformave Ekonomike;
8. Seminar me ekspertë të jashtëm të Delegacionit të Bashkimit Evropian mbi turizmin, trashëgiminë kulturore dhe zhvillimin rajonal;
9. Takimet e projektit SMEI4 me ministritë e linjës për përgatitjen e analizave të mangësive ligjore për kapitujt 11,12,13,15, 27, etj;
10. Konferenca Kombëtare Vjetore mbi Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale nën sloganin “*Inovacioni përmirëson cilësinë e jetës*”, 6 prill 2017, "Tirana International";
11. Konferenca rajonale mbi shfrytëzimin e burimeve hidrike në vendet e Ballkanit Perëndimor.
12. Tryeza e Rrumbullakët Rajonale mbi komunikimin për Bashkimin Evropian në vendet e zgjerimit, zhvilluar në Tiranë, me datë 1 qershor 2017;
13. Tryeza e Rrumbullakët “*Demokracia dhe shoqëria shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme*”, zhvilluar në Tiranë, me datë 16 qershor 2017;
14. Konferenca rajonale mbi shfrytëzimin e burimeve hidrike në vendet e Ballkanit Perëndimor;
15. Misioni i eksperteve të organizuar nga instrumentet TAIEX me datën 26-30 qershor 2017 në Tirane, Shqipëri, mbirshikimin e kurikulave për arsimimin e infermiereve;
16. 21-23 Qershor 2017 – Trajnim interaktiv (*coaching*) mbi monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e fondeve IPA, në kuadër të IPA II, me pjesëmarrjen e punonjësve tëMIE-s dhe Ministrive të linjës, përfituese të programeve/projekteve IPA.

Bashkëpunimi Territorial

Në cilësinë e saj si Autoritet Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial, Ministria e Integritimit Europian, ka punuar ngushtësisht me strukturat homologe për të mundësuar zbatimin e Programeve Ndërkufitare dhe Transnacionale në të cilat vendi ynë merr pjesë gjatë perspektivës IPA II. Një

rëndësi e veçantë, gjatë këtij tre mujori, i është kushtuar nënshkrimit të Marrëveshjeve të Financimit, hartimit dhe shpalljes së thirrjeve për projekt propozime, si dhe vlerësimit të tyre.

Programi IPA CBC Shqipëri-Kosovë 2014-2020 – Gjatë periudhës së raportimit (Prill, Maj, Qershor) në kuadër të këtij programi ka vijuar procesi i vlerësimit të aplikimeve të ardhura në kuadër të thirrjes së parë për projekt-propozime. Njoftohemi se në tërësi kanë ardhur mbi 90 aplikime (*koncept-nota*) dhe pritet që lista paraprake e fituesve të fazës së parë (koncept-notës) të shpallet gjatë muajit Korrik 2017. Projektet që do kalojnë këtë fazë do dërgojnë aplikimin e plotë dhe pritet që i gjithë procesi të mbyllet në Nëntor 2017. Zyra e Sekretariatit të Përbashkët Teknik me seli në Kukës është tashmë e plotësuar me stafin përkatës dhe tërësisht funksionale.

Në kuadër të **Programit IPA CBC Maqedoni-Shqipëri 2014-2020**, në Qershor 2017 u organizua në Peshkopi takimi i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (JMC), gjatë të cilit u diskutua lista e projekteve fituese të Thirrjes së parë për projekt propozime me vlerë totale rreth 3 Milion Euro. Gjithsej u sugjeruan të miratohen 8 projekte me gjeografi zbatimi në Qarqet e Elbasanit, Korçës dhe Dibrës. Zbatimi i projekteve fituese mendohet të fillojë në Shtator-Tetor 2017.

Programi IPA CBC Mali i Zi-Shqipëri – gjatë periudhës Prill – Qershor 2017 është proceduar për vlerësimin e projekteve të thirrjes së parë për projekt-propozime. Procesi i vlerësimit mendohet të mbyllet në Korrik 2017 dhe projektet të nisnin zbatimin në Shtator-tetor 2017.

Programi Trilateral Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi – Thirrja e parë për projekt propozime (me vlerë 25 Milion Euro) është shpallur në Mars 2017 dhe qëndroi e hapur deri në 30 maj 2017. MIE ka organizuar një fushatë informuese për prezantimin e këtij programi dhe për lançimin e thirrjes së parë për projekte me qëllim maksimizimin e pjesëmarrjes së partnerëve shqiptarë në aplikime. Nga të dhënat e para rezulton se ka patur 185 aplikime, me një përfshirje rekord prej 316 aplikantësh shqiptarë. Mendohet se procesi i vlerësimit do përmbyllet në fund të Shtatorit 2017.

Programi Interreg IPA CBC Greqi-Shqipëri – MIE ka ndjekur procesin e vlerësimit të projekt propozimeve të thirrjes së dytë për projekte nga e cila pati një numër relativisht të lartë projektesh të dorëzuara (200 në total), procesi i cili u përmbyll në Maj 2017, për të vijuar më pas me miratimin e projekteve fituese në Korrik 2017 nga Komiteti i Monitorimit të Programit. Mendohet se procedura e nënshkrimit të kontratave me përfituesit do finalizohet në Shtator-Tetor 2017. Nga aplikimet e shqyrtuara, vërejmë se ka një numër të lartë aplikantësh nga njësitë e qeverisjes lokale dhe një shtrirje të zonave të zbatimit të projekteve në katër Qarqet e Jugut: Berat, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë, ku dy të fundit kanë një intensitet më të lartë aplikantësh. Projekt-propozimet targetojnë prioritetet e thirrjes si më poshtë: menaxhimi i ujit dhe mbetjeve, mbrojtja e mjedisit, efikasiteti e energjisë, promovimi i resurseve natyrore e kulturore, nxitja e turizmit, nxitja e sipërmarrjes, etj.

Përsa i përket Programit **Interreg ADRION** – Në muajin Maj 2017 u zhvillua takimi i Komitetit të Monitorimit të Programit ku u njoftua se ka përfunduar procesi i vlerësimit të propozimeve të thirrjes së parë dhe u paraqit lista e projekteve fituese. Sipas këtyre rezultateve, në total u miratua një buxhet prej rreth 39 Milion Euro të ndarë në 35 projekte fituese. Sipas të dhënave, në grupin e projekteve fituese ka **73 partnerë IPA**, nga të cilët **29 janë nga Shqipëria**, numri më i lartë krahasuar me vendet e tjera të Rajonit. Mendohet se Kontratat e Financimit do të lidhen në muajin Shtator 2017. Është vërejtur se ka një prezencë të lartë partnerësh nga sektori publikë dhe vetëm pak

nga ai privat jo-fitimprurës. Vërejmë jo pak partnerë nga Qarku Durrës, si psh: Bashkia, Porti, Këshilli i Qarkut, etj. Partnerë aktivë gjithashtu janë edhe Dhomat e tregtisë, FSHZH etj. Projekt-propozimet targetojnë prioritetet e thirrjes si më poshtë: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e transportit të qëndrueshëm dhe përmirësimin e infrastrukturës publike, nxitja e konkurrencës, mjedisit të biznesit si edhe promovimi i resurseve kulturore dhe natyrore.

Lidhur me **Programin Interreg Ballkan-Mediterranean**, Komiteti i Monitorimit miratoi listën prej 37 projektesh të përzgjedhura për financim, të cilat do të nënshtrohen procesit nënshkrimit të kontratave respektive. Në këto projekte ka një numër të madh partnerësh shqiptarë krahasuar me vendin tjetër IPA pjesëmarrës në Program (Maqedoninë). Projektet do adresojnë prioritetet e tilla si, konkurrenca, inovacioni, mjedisi, etj. Vërejmë se aplikantët shqiptarë janë kryesisht Bashki, Universitete, Dhoma e Tregtisë si edhe disa OJF. Ndërkohë, nënshkrimi i Marrëveshjes së Financimit për këtë Program është finalizuar nga të treja palët: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Autoriteti Menaxhues Grek dhe Komisioni Europian.

Programin Interreg Mesdheu (MED) – Thirrja e dytë e Programit MED u lançua për projekte të integruara, gjatë periudhës Janar – Mars 2017. Gjithsej pati 51 aplikime, nga të cilat vetëm 14 u kualifikuan për në fazën e dytë (aplikimin e plotë). Vlerësimi i projekteve (koncept-notave) u krye gjatë periudhës Prill-Maj 2017 dhe lajmi i mirë është që në projektet e kualifikuara, Shqipëria ka përfunduar me partner në 9 prej tyre, me gjithsej 11 partnerë të përfshirë, një numër më i lartë krahasuar me një pjesë të madhe të vendeve pjesëmarrëse. Vërejmë pjesëmarrje të kënaqshme të Institutit të Transportit, Ministrisë së Transportit, Ministrisë së Mjedisit, Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, Universitete etj. Mendohet se të 14 projektet do të financohen nga Programi nëse plotësojnë në kohë aplikimin e plotë (deri në Tetor 2017). Projektet adresojnë prioritetet si: inovacioni, mbrojtja e mjedisit, nxitja dhe promovimi i resurseve kulturore dhe natyrore, etj. Përsa i përket Marrëveshjes së Financimit të këtij programi, aktualisht ajo është nënshkruar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe nga Komisioni Europian, ndërkohë që pritjet të nënshkruhet brenda fillimit të Korrikut edhe nga Autoriteti Menaxhues Francez.

Për sa i përket **monitorimit të projekteve** të Bashkëpunimit Ndërkufitar për periudhën 2007 – 2013 të programit IPA, gjatë vitit 2017 ka vazhduar monitorimi i të gjithë projekteve dhe programeve në zbatim. Gjatë monitorimit të vazhdueshëm, përfituesit shqiptarë janë mbështetur nga stafi i Ministrisë së Integrimit Europian, për zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë zbatimit të projekteve. Gjatë periudhës Prill-Qershor 2017, problematikat janë lidhur kryesisht me çështjen e ofsetimeve të disa projekteve të cilat kanë sjellë edhe krijimin e detyrimeve financiare ndaj Komisionit Evropian. Për këtë qëllim, MIE është angazhuar në komunikime të drejtpërdrejta me përfituesit për të bërë të mundur shlyerjen e këtyre detyrimeve. Nga perspektiva e mëparshme financiare, IPA I - 2007-2013, aktualisht janë ende në zbatim, vetëm 5 projekte strategjike infrastrukturore të financuara nga programet e bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, Shqipëri-Mal i Zi dhe Shqipëri-Kosovë. Nuk janë identifikuar problematika serioze në zbatimin e këtyre projekteve me përjashtim të disa vonesave në zbatimin e disa aktiviteteve për të cilat është kërkuar zgjatje e kontratave aktuale, miratuar edhe Delegacionit të BE-se në Shqipëri, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

IPA Kombëtare

Amendimi i Marrëveshjes së Financimit për Programin IPA 2009

Gjatë muajit mars 2017, KKIPA ka kërkuar një ndryshim jo – thelbësor në Vendimin dhe në Marrëveshjen e Financimit që rregullon Programin Kombëtar IPA 2009 për Shqipërinë, dhe në datën 4 prill 2017 Komisioni Europian ka dërguar shkresën miratuese për të kryer amendimin e kërkuar. Shtyrja e afatit të zbatimit për projektin N^o.12, në lidhje me “Ndërtimin e infrastrukturave të ujësjellës dhe kanalizimeve në Kamëz, Kavajë, Lezhë / Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë/Ksamil, ishte thelbësore, në mënyrë që projekti dhe infrastruktura e ndërtuar të përfundojnë me sukses.

Procesi i programimit të IPA 2016 – Marrëveshja Financiare IPA 2016

Pas nënshkrimit nga Shërbimet e Komisionit Europian në datën 21.3.2017 të Marrëveshjes së Financimit që miraton paketën e projekteve për programin IPA 2016, kanë nisur procedurat e brendshme kombëtare për Miratim nga Këshilli i Ministrave dhe nënshkrimi më tej nga KKIPA i kësaj Marrëveshje.

Ministria e Integrimit Europian, pasi ka marrë mendimet e ministrive të linjës, ka dërguar në datën 21 qershor paketën pranë Këshillit të Ministrave dhe pritet miratimi në parim i Marrëveshjes në mbledhjen më të afërme të Qeverisë.

Procesi i programimit të IPA 2017

Në kuadër të procesit të rishikimit të Dokumentit Strategjik Kombëtar 2014 -2020, jemi informuar nga DBE që miratimi do të shtyhet për vitin e ardhshëm, brenda muajit mars 2018.

Ndërkohë, vijon procesi i programimit të fondeve IPA 2017-2018 dhe jemi informuar nga Komisioni Europian se për rrjedhojë e mos miratimit të Dokumentit Strategjik Kombëtar brenda afatit që ishte përcaktuar më parë (tetor 2017), programet do të ndahen. Si pasojë, programet që do të financohen nga IPA 2017 janë Fondi i BE-së për integrimin (EU integration facility) dhe Dokumenti i Veprimit në mbështetje të fushave të Konkurrueshmërisë dhe Inovacioni. Ndërsa nëpërmjet programit IPA 2018 Dokumentat e Veprimit që do të financohen nën janë për fushat e Ujit, Drejtësisë dhe Programeve Europiane.

Draftet e Dokumenteve të Veprimit për Programin IPA 2017 janë dërguar pranë Komisionit Europian gjatë muajit maj, pas reflektimit të komenteve të DBE-së nga institucionet përfituese. Nga ana e DBE jemi informuar që më datë 14 Korrik do të zhvillohet Fast Committee, nga i cili do të dalin komentet dhe sugjerimet për secilin Dokument Veprimi.

Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF)

Në datat 14-15 Qershor 2017 është zhvilluar takimi i 17^{të} i Komitetit Drejtues të të Instrumentit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (ËBIF). Në konkluzion të takimit të Komitetit Drejtues të ËBIF theksojmë pikat e mëposhtme:

- Shqipëria ishte vendi që fitoi numrin më të madh të projekteve, si dhe fondeve grant, në thirrjen e 17^{të} për Asistencën Teknike të WBIF;
 - Rindërtimi i Kalatave 1 & 2 në Portin e Durrësit: 1,100,000 Euro;
 - Ndërtimi i by Pass-it të Lezhës: 350,000 Euro;
 - Mbështetje për zhvillimin e Hidrocentralit të Skavicës: 1,500,000 Euro;
 - Zhvillimi i sipërmarrjes lokale dhe turizmit ndërkufitar përgjatë Liqenit të Shkodrës përmes përmirësimeve në Infrastrukturën e Biznesit në një mënyrë të qëndrueshme mjedisore: 400,000 Euro;
 - Projekti Rajonal: Energjia/OST Transmission: 1,040,000 Euro.
- Numri i projekteve të aplikuara nga i gjithë rajoni në thirrjen e 17^{të} është 24, me një shumë granti të kërkuar prej 22,509,300 Euro;
- Numri i projekteve të përzgjedhura për të gjithë rajonin është 12 me një shumë granti prej 11,300,000 Euro;
- Numri i projekteve të aplikuara sipas sektorëve është: Social 6, Mjedis 7, Energji 3, Transport 8;
- Numri i projekteve të përzgjedhura sipas sektorëve është: Social 2, Mjedis 2, Energji 3, Transport 5.

Monitorimi i projekteve IPA në zbatim

Gjatë tre-mujorit të dytë të 2017, u shënuar vijimësi e çështjeve problematike të projekteve IPA në zbatim (gjithsej 5 projekte), ndonëse disa çështje janë zgjidhur. Drejtoria mbështetëse e KKIPA po koordinon me institucionet përfituese adresimin e tyre me qëllim rikthimin e ecurisë normale të projekteve apo funksionimin dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura pas përfundimit të projekteve IPA.

Referuar projekteve nën menaxhim të decentralizuar, performanca e tyre deri tani paraqitet në përgjithësi e mirë, me ndonjë përjashtim, të cilat janë normale duke qenë se sistemi i menaxhimit të decentralizuar është në periudhë konsolidimi - çështje të cilat po adresohen falë bashkëpunimit mes Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (KKIPA/MIE), Autoritetit Kontraktues (MF) dhe institucionit përfitues të projektit. Çështja kryesore problematike lidhur me këto projekte ka të bëjë me nevojën e përsheptimit të procedurave të prokurimit me qëllim arritjen e afatit të kontraktimit për një numër të vogël kontratash të programit IPA 2013.

Në kuadrin e programeve të mbështetjes buxhetore për (i) Reformën në Menaxhimin e Financave Publike (ii) Reformën në Administratën Publike dhe (iii) Punësimin, planet e aktiviteteve bazuar në strategjitë përkatëse të reformave janë duke u zbatuar. Kërkesa për lëvizimin e transhit të radhës për dy programet e para është nën diskutim në Komisionin Europian, ndërsa është në proces dorëzimi kërkesa (së bashku me raportet përkatëse) për lëvizimin e transhit të dytë të mbështetjes buxhetore për programin “Punësimi dhe aftësimi” (shuma e kërkuar 6.3 milion Euro).

Procesi i adresimit të një pjese të vogël të mbetur të gjetjeve dhe rekomandimeve të misioneve të auditimit të Komisionit European lidhur me marrjen e besimit për menaxhimin indirekt të programeve IPA 2014 dhe 2015, po vazhdon. E në këtë kuadër, për të diskutuar ecurinë, mes autoriteteve Shqiptare dhe auditorëve të DG-Near u mbajt një takim i shkurtër konsultativ, gjatë muajit Qershor. Takim, në të cilin u bë me dije se një vizitë tjetër verifikuese e mirëfilltë dhe e detajuar, do të mbahet nga auditorët gjatë muajit Nëntor 2017.

Në vijim të aplikimit për zbatimin e Programit të Asistencës së Zhvillimit Rural (IPARD II), autoritetet Shqiptare, nën koordinimin e NAO/ZKA, përgatitën dhe dërguan pranë DG-Agri observimet/komentet dhe planin e veprimit për adresimin/qartësimin e gjetjeve paraprake nga ana e auditorëve. Dërgimi i observimeve/komenteve dhe planit të veprimit do të shërbejë si bazë për hartimin e raportit dhe opinionit final nga ana e auditorëve. Gjithashtu, nga ana e Autoritetit Menaxhues është përgatitur dhe dorëzuar Lista e Shpenzimeve të Pranueshme për secilën nga masat e Programit IPARD të miratuar.